

Rregullore e Promocionit “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” të organizuar nga “Coca-Cola Bottling Shqipëria” (CCBS)

1. Subjekti organizues i promocionit “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” është shoqëria Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk. (CCBS), NUIS J61901061H, me seli në adresën: Rr. Kombëtare Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë.
2. Promocioni “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Promocioni “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” do të zhvillohet duke filluar nga data 9 Tetor 2024 deri në 3 Nëntor 2024.
4. Mund të marrin pjesë në promocion “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” të gjithë personat fizikë me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, te cilet janë mbi 18 Vjec, që prej datës 9 Tetor 2024 deri në 3 Nëntor 2024, të cilët blejnë produktet Coca-Cola Zero, kanace 0.33L. Produkte i prodhuar nga Coca-Cola Bottling Shqipëria shpk.
5. Nuk mund të marrin pjesë në promocionin “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” punëmarrësit e subjektit organizues, titullarët e distributorëve të autorizuar, apo punëmarrësit e pikave të shitjes ku tregëtohen produktet e CCBS, familjarët e personave të mësipërm (bashkëshort, bashkëjetues, prindër, fëmijë, vëllezër dhe motra).
6. Produktet e CCBS të përfshira në këtë promocion do të shiten me çmimin normal të tregut. Çmimi i rekomanduar i tregut për këtë produkt gjendet në tabelën me poshte:

Produktet pjesë e promocionit	Çmimi i rekomanduar për konsumatorin /copë (Pa TVSH)	Çmimi i rekomanduar për konsumatorin /copë (Me TVSH)
Coca-Cola Zero 0.33L	66.67 Lekë	80 Lekë

Për të marrë pjesë në promocion konsumatorët duhet të dërgojnë kodin me mesazh nëpërmjet website www.promo.ccbs.al pa kosto. Kompania e cila do të menaxhojë dhe monitorojë website do të jetë IUP me adrese: Rr.Themistokli Gërmenji Nr.1 Tiranë 1001, Mekanika e promocionit “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” konsiston në një kombinim të formulave “Gjej kodin nën hapësen e kuqe të kanaçes promocionale dhe bëhu pjesë e shorteut “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**”.

7. Për të marrë pjesë në promocionin “**Loja Promocionale Coca-Cola Zero**” dhe për të fituar çmimet e vëna në dispozicion nga CCBS, pjesëmarrësit duhet të ndjekin udhëzimet vijuese të përcaktuara në këtë rregullore:
 - Konsumatori duhet të dërgojë kodin alfanumerik të gjetur nën hapësen e kuqe të kanaçeve promocionale, në website www.promo.ccbs.al
 - Konsumatorët duhet të plotësojnë të dhënat e kërkuara në website www.promo.ccbs.al
 - Konsumatori duhet të jetë mbi 18 vjec.
 - Loja promocionale do të jetë e vlefshme: Nga data 9 Tetor 2024 deri në 3 Nëntor 2024, ku çdo të Hënë në orën 10:00, në praninë e një noteri publik të autorizuar nga CCBS, **do të bëhet hedhja e shorteut për të shpallur 3 fitues çdo javë, në total gjatë lojës promocionale do të shpallen 12 fitues për 12 dhurata.** Një fitues fiton një dhuratë të cilat do të jetë: një Iphone 15 Pro 256GB , një Apple Watch Series 9 dhe një Apple AirPods 3rd Generation.

- Fitues do të jenë 3 numrat e parë të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Noteri do të certifikojë me anë të një procesverbal, i cili do të mbahet në momentin e hedhjes së shorteut dhe përzgjedhjes së kodit fitues. Ky procesverbal do të firmoset nga personat e pranishëm të cilët do të jenë; një punonjës i autorizuar nga CCBS, një punonjës i autorizuar nga IUP me adresë: Rr.Themistokli Gërmenji Nr.1, 1001, Tiranë një punonjës i autorizuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave te Fatit, një punonjës i autorizuar nga Tatimet si dhe Noteri Publik ose Asistent Noteri i autorizuar nga CCBS.
Ditët e pushimit do të zëvendësohen nga dita pasardhëse.
- Vendi ku do të hidhet shorteu për zgjedhjen e fituesit është prane agjensis IUP me adresë: Rr.Themistokli Gërmenji Nr.1, 1001, Tiranë.
- Mënyra e zgjedhjes së fituesit do të jetë rastësore nga sistemi. Do të përzgjidhen në mënyrë rastësore 15 numra për shorte dhe fitues të një shorteu konsiderohen 3 numrat e parë në radhë, 12 numrat e tjerë do të mbahen rezervë. Të gjitha kodet e dërguar do të verifikohen nëse janë te sakta ose jo. Çdo kod i dubluar ose i shkruar gabim do të refuzohet. Konsumatorët në momentin që vendosin kodin do të njoftohen nëse kodi i tyre u pranua ose jo. Organizatori nuk mban përgjegjësi në rast ngarkese ose mosfunksionim të rrjetit.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij promovioni, konsumatorët do të kenë mundësinë të fitojnë në total:

- 12 dhurata: 4 Iphone 15 Pro 256GB, 4 Apple Watch Series 9 dhe 4 Apple Airpods 3rd Generation
- Vlera totale e dhuratave është si më poshtë:

Përshkrimi i produktit	Sasia			
		Cmimi/Cope(Lek,pa TVSH)	Total (Lek,pa TVSH)	Total (Lek,me TVSH)
Iphone 15 Pro 256GB	4	87,492	349,967	419,960
Apple Watch Series 9	4	29,158	116,633	139,960
Apple Airpods 3rd Generation	4	13,742	54,967	65,960
			521,566.68	625,880.02

*Çmimet **nuk** janë të konvertueshme në para.

8. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në promovionin “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” është rreth 7.6 milion.

Shpërndarja e dhuratave do të bëhet në ambientet e CCBS. Fituesit mund të tërheqin dhuratën nga e Hëna në të Premte, nga ora 10:00-16:00 nga data 15 Tetor 2024 deri në 8 Nëntor 2024. Tërheqja e dhuratës mund të kryhet vetëm me paraqitjen e dokumentit të identifikimit të fituesit. Fituesi duhet të firmosi në momentin e marrjes së dhuratës procesverbalin e marrjes në dorëzim të dhuratës si dhe faturën përkatëse. Fituesi do të përfitojë dhuratën brenda një harku kohor prej 10 ditë pune nga data e shpalljes fitues.

Nëse Fituesi nuk do të paraqitet, brënda afatit ditor prej 10 ditë pune, për të tërhequr dhuratën, ai pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj CCBS, lidhur me dhuratën e përfituar, pasi ai humb të drejtën si fitues i këtij Promocioni dhe CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës të përzgjedhur në të njëjtën ditë me fituesin që ka refuzuar të tërheqë dhuratën.

Pjesëmarrës në shorte do të jenë të gjithë klientët që kanë dërguar kode në website gjatë periudhës respektive:

- **Shorteu parë : 14 Tetor (një Iphone 15 Pro 256GB, një Apple Watch Series 9 dhe një Apple AirPods 3rd Generation):** Numrat pjesëmarrës në shorteun e datës 14 Tetor 2024 ora 10:00 do të llogariten sms e dërguara nga ora 00:00 e ditës së mërkurë datë 9 Tetor 2024 deri ditën e dielë 13 Tetor 2024 ora 23:59.
- **Shorteu Dytë: 21 Tetor (një Iphone 15 Pro 256GB, një Apple Watch Series 9 dhe një Apple AirPods 3rd Generation):** Numrat pjesëmarrës në shorteun e datës 21 Tetor 2024 ora 10:00 do të llogariten sms e dërguara nga ora 00:00 e ditës së hënë datë 14 Tetor 2024 deri ditën e dielë 20 Tetor 2024 ora 23:59.
- **Shorteu Tretë: 28 Tetor (një Iphone 15 Pro 256GB, një Apple Watch Series 9 dhe një Apple AirPods 3rd Generation):** Numrat pjesëmarrës në shorteun e datës 28 Tetor 2024 ora 10:00 do të llogariten sms e dërguara nga ora 00:00 e ditës së hënë 21 Tetor 2024 deri ditën e dielë 27 Tetor 2024 ora 23:59.
- **Shorteu Katërt: 4 Nëntor (një Iphone 15 Pro 256GB, një Apple Watch Series 9 dhe një Apple AirPods 3rd Generation):** Numrat pjesëmarrës në shorteun e datës 4 Nëntor 2024 ora 10:00 do të llogariten sms e dërguara nga ora 00:00 e ditës së hënë 28 Tetor 2024 deri ditën e dielë 3 Nëntor 2024 ora 23:59.

Fituesi do të:

- a) Njoftohet me telefon brënda ditës së hedhjes së shorteut. Nëse fituesi nuk përgjigjet në telefon apo numri nuk është disponueshëm, atëherë CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës.
- b) Në rast se fituesi nuk përgjigjet në telefon apo numri nuk është i disponueshëm pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim lidhur me humbjen e të drejtës si fitues i këtij Promocioni.
- c) Duhet të japë me telefon kredencialet e plota si: emë, mbiemër, atësi, numrin e kartës së identitetit, qytetin dhe adresën e saktë të banimit. Nëse fituesi nuk përgjigjet në telefon gjtë ditës së hedhjes së shorteut CCBS i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës.
- d) Të gjitha të dhënat personale do të përpunohen nga CCBS vetëm për qëllimin e këtij promocioni dhe do të shkatërrohen brënda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhuratave, sipas ligjit në fuqi, duke mos lejuar humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen të të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara. Të dhënat personale të mbledhura nga CCBS dhe IUP me adrese: Rr.Themistokli Gërmenji Nr.1, 1001, Tiranë në kuadër të këtij promocioni dhe sipas kushteve të kësaj rregullore, do të trajtohen në përputhje me LIGJ “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

- e) CCBS nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm financiar apo jofinanciar (përfshirë dëmin apo fitimin e munguar) që mund të rezultojë si pasojë e pjesëmarrjes në promovimin “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” përjashtuar përgjegjësinë ligjore të CCBS.
- f) Këto rregulla do të botohen pjesërisht në materialet promovionale dhe plotësisht në website (www.promo.ccbs.al).
- g) Në rast gabimesh në stampim apo të çdo parregullsie tjetër të hapeses së kanacës promovionale, përfshi këtu fshirjen e pjesëshme apo modifikimin e kodeve sipas vlerësimit të vetëm të subjektit organizues, subjekti organizues CCBS apo çdo partner i autorizuar, nuk do të jetë përgjegjës apo i detyruar për dhënien e dhuratës. Pjesëmarrësit në këtë promovim nuk kanë të drejtë të kërkojnë çmim në sasi më të madhe, apo çmim të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga subjekti organizues i fushatës sipas kësaj rregulloreje. Çmimet e mësipërme nuk janë të konvertueshme në para. Duke marrë pjesë në këtë promovim, pjesëmarrësit detyrohen të respektojnë këtë rregullore.
- h) Promocioni “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” mund të ndërpritet në rast force madhore dhe/ ose Fatkeqesie Natyrore (rrethana të cila Shoqëria nuk mund t'i kishte parashikuar apo influencuar), përfshirë pamundësinë e CCBS për të vazhduar promovimin “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” për arsye që nuk varen nga vullneti i saj. CCBS do të informojë konsumatorët me mjetet e duhura në rast ndërprerjeje të promovimit “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” duke dhënë edhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në raste të tilla, CCBS nuk do të ketë detyrimin për të dëmshpërblyer pjesëmarrësit për çdo shpenzim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në promovim.
- i) Promocioni “Loja Promocionale Coca-Cola Zero” është një ofertë që i drejtohet publikut dhe bazohet në nenet 661, 665, 667 paragrafi i parë dhe i tretë, 670 e 671 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Organizimi i promovimit “Promocioni Coca-Cola Zero 2023” bëhet në përputhje me Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017 “Përcaktimin E Mënyrave, Formave, Kriteve Dhe Rregullave Për Organizimin E Lojërave Të Fatit Promocionale”. Personat që sipas parashikimeve të kësaj rregullore kanë të drejtë të tërheqin çmimet e vëna në lojë, nëse hasin pengesë në tërheqjen e tyre mund të paraqesin çdo ankesë apo informacion në numrin e tel: +35545606060 ose në adresën e e-mailit: info@cocacola.al.
- j) Coca-Cola Zero është markë e regjistruara të “The Coca-Cola Company”.